



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të të drejtave që burojnë nga neni 6 i Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 14 janar 2012,

Bordi i Federatës së Tenisit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 6 gusht 2018, miratoi këtë:

# **PLAN STRATEGJIK**

# **ZHVILLIMOR**

# **2019-2021**



## **PËRMBAJTJA**

<b>LISTA E SHKURTESAVE</b> .....	2
<b>FALENDERIMET</b> .....	3
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	4
<b>HYRJE</b> .....	5
<b>1. ANALIZA E GJENDJES</b> .....	6
<b>2. SISTEMI I OBJEKTIVAVE</b> .....	10
<b>3. PLANI I VEPRIMIT</b> .....	14
<b>4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI</b> .....	14
<b>SHTOJCA 1) PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT</b> .....	15
<b>SHTOJCA 2) OBJEKTIVAT E KUANTIFIKUARA 2017-2021 – ECURIA</b> .....	20



## LISTA E SHKURTESAVE

ETF	Federata Evropiane e Tenisit
EU	Bashkimi Evropian
Federata	Federata e Tenisit e Kosovës
ITF	Federata Ndërkombëtare e Tenisit
KOK	Komiteti Olimpik i Kosovës
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
OZh	Objektiva zhvillimore



## FALËNDERIME

Një meritë dhe falënderim i veçantë i takon KOK-ut që mundësoi pjesëmarrjen e anëtarëve të Federatës në kursin për administratorë të sportit në mars 2018. Gjatë ndjekjes së programit në fjalë u bë tejet e qartë për të gjithë komunitetin e tenisit se sa ishte e nevojshme reforma dhe planifikimi strategjik.

Falenderim tjetër shkon për grupin koordinues në përbërje: Fjolla Ibishi, Shkëlzen Domi, Veton Sylhasi dhe Vërshim Hatipi; dhe në veçanti për Jeton Hadërgjonajn që në koordinim me ITF-in vuri themelet e këtij plani; si dhe për gjithë njerëzit nga komuniteti i tenisit që ofruan mendimet dhe qëndrimet e tyre.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani zhvillimor i tenisit në Kosovë është produkt i bashkëpunimit të Federatës me të gjitha palët e përfshira në sportin e tenisit dhe sportin në përgjithësi.

Procesi i hartimit të planit zhvillimor ka qenë proces i bazuar në pjesëmarrje, duke përfaqësuar deri në masën më të madhe të mundshme këndvështrimet e secilës palë por duke pasur parasysh edhe interesin e përgjithshëm.

Konsultimet me palët kanë zgjatur për tre muaj të tërë, prill-qershor 2018, ndërkohë që procesi ka shkuar nëpër pesë hapa kryesorë:

1. Përgatitja për procesin;
2. Analiza e gjendjes;
3. Definimi i sistemit të objektivave;
4. Përcaktimi i planit të veprimit;
5. Hartimi i dokumentit të planit zhvillimor.

Analiza e gjendjes ka zbuluar katër fusha të veçanta për zhvillim: 1.) Financimi i tenisit; 2.) Qeverisja dhe menaxhimi i tenisit; 3.) Pjesëmarrja në tenis; dhe 4.) Performanca në tenis. Përderisa fusha e parë, që lidhet me financimin, është trajtuar në formë tërthore përgjatë tri fushave të tjera, këto të fundit janë përkthyer në objektiva zhvillimore strategjike.

**OZh 1:** Qeverisje efektive e bazuar në punë profesionale, në komunikim bashkëpunues në të gjitha nivelet, si dhe në vendimmarrje të informuar.

**OZh 2:** Pjesëmarrje e shtuar e popullatës në sportin e tenisit.

**OZh 3:** Përmirësim i performancës në tenis përmes zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe atyre infrastrukturore.

Analiza ka identifikuar edhe vizionin dhe misionin e Federatës, si dhe vlerat të cilat do ta ofrojnë vendosmërinë dhe mundësojnë realizimin e suksesshëm të planit. Ato janë përkufizuar si në vijim:

**Vizioni:** Një shoqëri sportdashëse dhe e shëndetshme ku tenisi zë vend të rëndësishëm si në aspekt të sasisë ashtu edhe të cilësisë.

**Misioni:** Promovimi i tenisit si sport me shtrirje të gjerë në popullatën e Kosovës dhe me rezultate konkurruese me sportet e tjera.

**Vlerat:** Transparenca e llogaridhënia, rrishtë, bashkëpunimi dhe partneriteti, gjithëpërfshirja, respekti dhe trajtimi i barabartë, dhe fryma edukative.

Për secilin objektiv zhvillimor të theksuar sipër, në planin e veprimit janë përcaktuar 14 masat që çojnë në arritjen e tij. Këto masa janë konkretizuar tutje përmes nënmasave apo veprimeve konkrete, të shoqëruara me treguesit e matshëm dhe buxhetin. Vlera e mjeteve të nevojshme për zbatimin e planit për vitet 2019-2021 është €195,000 (përmbi shpenzimet aktuale).

Në fund është treguar mënyra e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit të veprimit, e cila bazohet në relevancë, efikasitet, efektshmëri, ndikim dhe qëndrueshmëri. Monitorimi dhe vlerësimi do të bëhet karshi treguesve të përcaktuar më parë.

## HYRJE

Federata e Tenisit e Kosovës në vitin 2018 e ka fokusuar punën e vet në zhvillimin e tenisit përmes krijimit të mundësive për tenistët, zhvillimit profesional të trajnerëve dhe profesionistëve të tjerë të tenisit si dhe përmirësimit të kapaciteteve qeverisëse në kuadër të vet Federatës.

Përderisa Federata i kishte të vendosura objektivat 5-vjeçare (2017-2021), ato nuk ishin përherë reale. Për më tepër, nuk kishte një plan veprimi për t'i realizuar këto objektiva. Në pranverë 2018 u vendos të hartohet një plan zhvillimor më i detajuar dhe i avancuar për tenis. Si parakusht për këtë, një grup i njerëzve nga komuniteti i tenisit në Kosovë mori pjesë në kursin për administratorë të sportit të organizuar nga KOK-u. Menjëherë pas kësaj një grup i udhëhequr nga anëtarë të Bordit të Federatës morën koordinimin e procesit të konsultave dhe të hartimit të planit zhvillimor. Ky proces u zhvillua në disa faza:

### Faza 1: Përgatitja për procesin

Grupi koordinues hapi procesin e komunikimit me të gjitha palët, duke u konsultuar me autoritetet qendrore të sportit, klubet, tenistët, prindërit e tenistëve të rinj, trajnerët, referët, bizneset, etj. Këto konsultime ndihmuan në përgatitjen për procesin e planifikimit të planit zhvillimor.

### Faza 2: Analiza e gjendjes

Duke e shfrytëzuar analizën SWOT si mjet vlerësimi, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara u analizua gjendja ekzistuese në tenis, duke identifikuar nevojat dhe mundësitë për zhvillimin e tenisit. U organizuan një mori takimesh individuale dhe me grupe të fokusuara ku u morën opinionet e palëve, dhe ato janë kthyer në kontribute gjatë analizës së gjendjes. Këto kontribute kanë krijuar fotografinë e përgjithshme të gjendjes së tenisit e cila u shfrytëzua për të avancuar planifikimin zhvillimor.

### Faza 3: Definimi i sistemit të objektivave

Grupi koordinues, u përforcua me përfaqësues të palëve të tjera të interesit, për të siguruar këndvështrimet e ndryshme gjatë procesit të përcaktimit të vizionit, misionit, vlerave dhe objektivave strategjike për tenis dhe Kosovës.

### Faza 4: Përcaktimi i planit të veprimit

Mbi bazën e sistemit të objektivave, u përcaktuan masat që duhet ndërmarrë në periudhën e ardhshme për të përmbushur objektivat. Këto masa u shqyrtuan në mënyrë kritike duke u fokusuar në aspektet e implementimit të tyre, resurseve të nevojshme për implementim dhe kontekstit shoqëror në të cilin do të implementohen.

### Faza 5: Hartimi i dokumentit të planit zhvillimor

Në bazë të dokumenteve punuese të prodhuara në fazat e mëparshme të procesit, u hartua drafti i dokumentit të planit zhvillimor, i cili pasi u shqyrtua nga grupi koordinues dhe pas komenteve nga palët e tjera, u finalizua dhe u aprovua në Bord.

## 1. ANALIZA E GJENDJES

Tenisi në Kosovë ende mbetet një sport i pazhvilluar dhe të cilit nuk i kushtohet vëmendje e duhur shoqërore dhe institucionale. Viteve të fundit po bëhen përpjekje që këtij sporti t'i jepet vendi i duhur në familjen e sporteve, ashtu siç e ka në shumicën e vendeve të botës.

### 1.1. Financimi i tenisit

Analiza e dokumentacionit të grumbulluar, por edhe pikëpamjet e palëve të interesit gjatë procesit të analizës së gjendjes kanë treguar se investimi në tenis është tejet i vogël.

Kjo më së miri vërehet tek infrastruktura, gjegjësisht fushat e tenisit, ku numërohen 35 fusha në 22 lokacione të ndryshme, në 9 qytete të ndryshme. Prej tyre vetëm 2 fusha janë të mbuluara dhe (kryesisht) të shfrytëzueshme gjatë vjeshtës dhe dimrit. Ferizaji, Gjlani e Gjakova - si 3 nga 7 qytetet më të mëdha të Kosovës – as sot nuk e kanë asnjë fushë tenisi.

Kosova ka nga një fushë për çdo 54.5 mijë banorë, dyfish më keq sesa Maqedonia (1:26.0 mijë), dhe shumëfish më keq se Serbia e Kroacia (përkatësisht 1:5.5 mijë, 1:1.8 mijë)<sup>1</sup>. Këto të fundit patjetër se sot janë superfuqi në tenis botëror. Disa projekte infrastrukturore megjithatë janë planifikuar dhe/apo janë në zbatim nga Ministria përkatëse për sport, mirëpo janë ende peng i procedurave të stërngadalshme, qoftë te dhënia e tokës nga niveli lokal, apo te alokimi i buxhetit për ndërtim nga niveli qendror.

Investimet e vogla (pothuajse inekzistente) nga sektori privat bëjnë që puna e Federatës dhe zyrtarëve e administratorëve të saj, e në masë të madhe edhe puna e klubeve, të jetë shumë e varur nga buxheti qendror si burim kryesor i financimit. Burimet e tjera të financimit janë të kohëpaskohshme dhe të kufizuara.

Në një situatë të këtillë të financimit të vogël për tenis, jo vetëm gjendja në infrastrukturë mbetet tejet e pavolitshme, por edhe krijohet dëshpërim i trajnerëve, referëve, si dhe prindërve për kushtet financiare të cilat nuk arrijnë të sigurojnë mbijetesë nga puna e bërë në tenis. Kjo bën që kapacitetet njerëzore të jenë të kufizuara.

Me pranimin e Federatës në ETF dhe ITF në 2016, krahas njohjes dhe prestigjit janë shtuar edhe obligimet financiare. Vetëm anëtarësimet në to, si dhe pjesëmarrjet në kampionatet Davis/Fed Cup gjatë 2018 i kanë kushtuar Federatës rreth 30 mijë euro, apo 40% e të hyrave nga MKRS. Kështu, Federata duhet pajtetër të gjejë një partner afatgjatë e serioz për sponsorizimin e sportit.

### 1.2. Qeverisja dhe menaxhimi i tenisit

Me pranimin e Federatës në ITF u krijuan mundësitë për një riorganizim të strukturave udhëheqëse të Federatës bazuar në praktikën e mira ndërkombëtare. Kjo në masë është reflektuar në klimën e përgjithshme në nivel të strukturave qeverisëse të tenisit, por edhe në nivel të komunitetit të tenisit në përgjithësi. Kjo klimë reflektohet përmes një entuziazmi për zhvillim institucional dhe veprimeve të ndërmarra për të rifunksionalizuar qeverisjen e tenisit në Kosovë.

<sup>1</sup> [European Tennis Report 2017](#)

Ky rifunksionalizim përfshin rregullativën e tenisit, përbërjen e organeve qeverisëse (Kuvendi dhe Bordi) dhe krijimin/funksionalizimin e organeve profesionale të Federatës. Ekziston një koncensus i përgjithshëm për ta zhvilluar tenisën sipas standardeve ndërkombëtare. Aspekt veçanërisht pozitiv i qeverisjes në Federatë është transparencja e duhur financiare.

Megjithatë, në aspektin qeverisës dhe organizativ ka të meta. Në mungesë të procedurave të definuara saktë që më herët, shpeshherë vendimmarrja është reaguese dhe jo sa duhet parimore apo e planifikuar, duke prodhuar paqartësi e pasiguri. Kështu mungojnë shumë rregullore që janë të rëndësishme për aspekte të ndryshme të menaxhimit të tenisit, ose ato janë aprovuar vite më parë duke u shndërruar në dokumente të padobishme e ndonjëherë edhe penguese për zhvillim të tenisit në rrethana të reja.

Klubet e tenisit nuk janë të organizuara mirë. Ato nuk kanë qeverisje adekuate, infrastrukturë të duhur e as resurse të mjaftueshme njerëzore; nuk kanë as plan zhvillimi a të menaxhimit, e rrjedhimisht as qëndrueshmëri financiare e formalitet. Disa prej tyre janë fare pak aktive, derisa të tjerat funksionojnë në mënyrë të atillë që nuk lejon zhvillimin e mjaftueshëm të tenisit. Komunikimi vertikal në mes të Federatës dhe klubeve, si dhe fryma e joformalitetit e krijuar ndër vite, kanë reflektuar në përgjithësi në planifikim, promovim dhe organizim të dobët të aktiviteteve të tenisit. Megjithatë, klubet kanë vërejtur dhe pranuar se nuk janë mirë, porse kanë shumë pak vullnet dhe motiv për t'u ndryshuar, dhe kjo do të jetë sfida e madhe për t'u adresuar.

Punët e Sekretariatit të Federatës deri vonë janë kryer “kush sa ka mundur e ditur”, dhe në mungesë të pagesave të rregullta apo të mjaftueshme, kanë përfunduar në duart e një apo dy personave që nuk e kanë as profilin, as kohën e duhur për të bërë më shumë. Megjithatë, ekziston vullnet i shtuar në Bord për të pasur një administratë prej 2-3 personash me orar të plotë, dhe për të lëvizur drejt një qeverisjeje dhe planifikimi më të mirë.

Shikuar me sy tejet kritik, mund të thuhet se për gjitha këto vite për shkak të rrethanave jo të mira dhe vështirësive, ka pasur premisa improvizimi edhe nga Federata, edhe klubet, edhe trajnerët e edhe referët. Megjithatë, falë punës së pandalur, kur merren parasysh të gjitha, gjendja, organizimi dhe funksionimi janë shumë më mirë se që do të duhej të ishin. Po ashtu, ka pasur edhe vendime shumë të mira, sidomos ato që kanë drejtuar fondet nga shpresat në synim që atyre t'u jepet gjasat për të shtuar konkurrencën dhe për të fituar sa më shumë përvojë.

### 1.3. Pjesëmarrja në tenis

Numri i fëmijëve të grupmoshave 7-11 vjeç nëpër klube që nga viti 2008 ka pasur një prirje të rënies, dhe arriti nivelin më të ulët në vitin 2016. Fatmirësisht, që nga atëherë prurjet e reja në klube dhe pjesëmarrjet në turne kanë prirje të theksuar të rritjes, megjithatë ato janë ende të pamjaftueshme.

Ndonëse një numër mjaft i madh i fëmijëve e provojnë tenisën (p.sh. K.T. Rilindja pati 120 fëmijë të ndryshëm U7/U9 gjatë 2017), një përqindje tejet e vogël ngelin në tenis për më shumë se 2-3 muaj (te K.T. Rilindja vetëm 18 nuk munguan asnjë muaj). Kjo për shkak se: a) tenisi nuk mësohet lehtë – prindërit kanë pritje për përparim më të shpejtë të lojës së fëmijës; b) ka pak fusha e trajnerë, dhe rrjedhimisht shumë fëmijë në një fushë në orar të caktuar; c) trajnerët/klubet nuk kanë vizion afatgjatë; dhe d) vjeshta dhe dimri pengojnë në mbajtje të fëmijëve.



Tek grumposhat më të mëdha ka rrjedhje lojtarësh që vijnë si pasojë e adoleshencës dhe konkurrencës së shtuar në njërin anë, si dhe vështirësive financiare të prindërve në anën tjetër. Kështu, praktikantët e shteteve të tjera tregojnë se për çdo tenist U18 që e kanë sot, duhet të kenë pasur 70-80 fëmijë U7-U11 vite më parë, dhe se të tjerët do të tërhiqen gjatë rrugës.

Kështu, falë popullaritetit dhe prestigjit të tenisit në botë, fëmijët dhe prindërit arrijnë të joshen për ta provuar këtë sport; por duhet shtuar edhe më shumë numrin e atyre që joshen edhe përqindjen e atyre që rrijnë në sport pasi ta kenë provuar.

Pjesëmarrja e femrave në tenis është bukur e madhe si përqindje krahasuar me shumë sporte të tjera, dhe kjo është diçka pozitive për sportin e tenisit. Megjithatë, ikjet tek vajzat janë edhe më të theksuara.

As numri i tenistëve që e praktikojnë këtë sport si rekreacion nuk është mjaftueshëm i madh. Në këtë sigurisht kanë ndikuar edhe kushtet infrastrukturore dhe çmimi i lartë i shërbimeve. Një gjë e tillë nuk mundëson kultivimin e kulturës së të luajturit tenis në shoqëri, e cila do t'i drejtonte gjeneratat e reja kah tenisi. Është identifikuar si rrezik që tenisi nuk konsiderohet sport prioritar nga shumica e popullatës kosovare.

#### 1.4. Performanca në tenis

Kapacitetet profesionale në tenis janë të zhvilluara shumë pak. Kryesisht ato mbështeten në entuziastë të tenisit që kanë një përvojë si tenistë aktivë apo rekreativë, apo edhe si sportistë në sporte tjera dhe sportdashës në përgjithësi. Veçanërisht janë të kufizuara kapacitetet e trajnerëve të tenisit, si një faktor shumë i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë së tenisit. Është vetëm një numër i kufizuar i trajnerëve (35) që vitet e fundit e kanë marrë licencën e ITF të nivelit të parë, ndërkohë që në pamundësi për të mbijetuar prej tenisit sot aktivë janë dy të tretat e tyre (22). Edhe kapacitetet e profesionistëve të tjerë janë të pazhvilluara duke mos lejuar profilizimin e duhur të profesionistëve gjë që reflektohet me përzjerje të kompetencave në nivel personal dhe institucional.

Federata me ndihmën e ITF vitet e fundit ka organizuar kurse për zhvillimin profesional të trajnerëve të tenisit, por shpesh pjesëmarrja e trajnerëve dhe dedikimi nuk ka qenë i kënaqshëm. Në anën tjetër nga këto kurse shpeshherë kanë përfituar vet tenistët e rinj të cilët janë ftuar për t'i praktikuar teknikat e trajnimeve, si dhe prindërit e këtyre tenistëve të rinj të cilët në mungesë të trajnerëve shpesh e kanë marrë mbi vete barrën e punës me fëmijët e tyre, sidomos në aspekte të ushtrimeve kondicionale. Tenistëve tanë të rinj u mungon fondi i duhur i orëve për ushtrime. Krahasuar me moshatarët e tyre në rajon, tenistët tanë të rinj ushtrojnë shumëfish më pak. Edhe kushtet e stërvitjeve dhe cilësia e stërvitjeve është më e ulët. Në njërin anë infrastruktura fizike është shumë e varfër, duke bërë që në kushte të dimrit, të ushtrojnë nëpër salla aspak të përshtatshme, sa për të mos e humbur ndjenjën e goditjes. Edhe investimi që u kërkohet familjeve për stërvitjen e tyre është shpeshherë në mospërputhje me mundësitë e tyre. Në anën tjetër, tashmë u cek që cilësia e trajnerëve nuk është e kënaqshme, pasi shumica e tyre nuk janë të profilizuar të punojnë me tenistë më të zhvilluar, por vetëm me kategoritë më të reja.

Disa nga tenistët e rinj vetëzhvillohen duke luajtur me bashkëmoshatarët e tyre nga vendet e tjera dhe në këtë drejtim ka rezultate të prekshme, pasi tenistët tanë të rinj janë gjithnjë e më konkurrentë, posaçërisht me bashkëmoshatarët e tyre në vendet fqinje. Federata në këtë drejtim ka krijuar lehtësira për pjesëmarrje të këtyre tenistëve në gara të federatave të shteteve fqinje si dhe në turnetë e Tennis Europe e ITF. Mirëpo, Federata deri tash, ndonëse ka pasur disa përpjekje nga ana e saj, nuk ka arritur të sigurojë kushte më të mira së paku për një numër të tenistëve premtues që të zhvillohen më tutje.

Një përpjekje e mirë organizative është bërë duke e promovuar dhe duke e përkrahur deri në një masë pjesëmarrjen e tenistëve të vendit në garat ndërkombëtare, gjë që ka ndikuar në krijimin e përvojës nga ana e tyre dhe mundësinë e zhvillimit përmes konkurrencës. Disa rezultate të tenistëve tanë të rinj në konkurrencë ndërkombëtare kanë nisur të shfaqen dhe kjo është premtuese.

Tek grupmosha e të rriturve Kosova ende ngel pa lojtarë me pikë ATP/WTA, dhe duhet ndihmuar tenistët aktualë që të rrisin sasinë dhe nivelin e turneve në të cilat marrin pjesë – dhe rezultatet do të pasojnë.

### Përmbledhje e gjendjes aktuale

Përshkrimi	Vlerësimi	Trendi
Fusha	●○○○	↔
Fusha të mbuluara	○○○○	↔
Trajnerë	●●○○	↑
Trajnerë cilësorë	●○○○	↔
Joshje fëmijësh	●●○○	↑
Mbajtje fëmijësh	●○○○	↔
Cilësi tenistësh	●○○○	↑
Përfshirje femrash	●●●○	↑
Përfshirje minoritetesh	●●●○	↑
Relevancë (në popullatë)	○○○○	↔
Rregull dhe organizim	●○○○	↑
Planifikim	●○○○	↑
Komunikim	●○○○	↑
Financa	●●○○	↑
Qeverisje e përgjithshme	●○○○	↑
Promovim i sportit	●○○○	↔

## 2. SISTEMI I OBJEKTIVAVE

### 2.1. Vizioni, misioni dhe vlerat

**Vizioni** i Federatës është: Një shoqëri sportdashëse dhe e shëndetshme ku tenisi zë vend të rëndësishëm si në aspekt të sasisë ashtu edhe të cilësisë.

**Misioni** që marrim përsipër është: Promovimi i tenisit si sport me shtrirje të gjerë në popullatën e Kosovës dhe me rezultate konkurruese me sportet e tjera.

Federata në rrugëtimin e vet do të udhëhiqet nga **vlerat** që krijojnë themelin për përgjegjësinë sociale të saj dhe për sigurimin e cilësisë. Këto vlera janë: transparenca e llogaridhënia, risitë (inovacioni), bashkëpunimi dhe partneriteti, gjithëpërfshirja, respekti e trajtimi i barabartë dhe fryma edukative.

### 2.2. Fushat zhvillimore

Analiza e gjendjes i ka bërë të dukshme katër fusha për zhvillim: qeverisjen dhe menaxhimin e tenisit, pjesëmarrjen në tenis, performancën në tenis dhe financimin/buxhetin për tenis. Kjo e fundit është një fushë që i përshkon fushat e tjera tërthorazi prandaj është vendosur që të trajtohet në mënyrë tërthore nëpër fushat tjera. Këto fusha të identifikuara për zhvillim janë shndërruar në objektiva zhvillimore.

#### 2.2.1. **OZh 1: Qeverisje efektive e bazuar në punë profesionale, në komunikim bashkëpunues në të gjitha nivelet, si dhe në vendimmarrje të informuar**

Zhvillimi i kapaciteteve qeverisëse e menaxhuese, profesionalizmi në punë dhe krijimi i një rrjeti të shëndoshë të bashkëpunimit në mes të të gjitha palëve të përfshira, janë faktorët kryesorë për një qeverisje efektive. Federata do të bashkëpunojë ngushtë me autoritetet qendrore të sportit, me institucionet ndërkombëtare, por edhe me klubet dhe shoqatat profesionale, për të krijuar një sistem demokratik të qeverisjes që udhëhiqet nga parimi i të mirës së përgjithshme.

##### **Masat për OZh 1:**

#### **a) Ristrukturimi i organeve qeverisëse të Federatës**

Për të siguruar efektivitet nevojitet të bëhet restrukturimi i Bordit Ekzekutiv dhe të konsolidohet përbërja e anëtarësisë së Kuvendit. Po ashtu do të themelohen dhe të vihen në funksion këshillat dhe komisionet e Bordit, për të lehtësuar menaxhimin e aspekteve të veçanta.

#### **b) Rishikimi i rregullativës dhe procedurave vendimmarrëse e administrative**

Në përputhje me standardet dhe zhvillimet ndërkombëtare është i nevojshëm rishikimi i kornizës rregullative. Kjo do të krijojë bazën për punën profesionale dhe do të evitohet diskrecionin në vendimmarrje. Do të rishikohet statuti dhe rregulloret ekzistuese, si dhe do të hartohen rregullore të reja. Më tej, do të hartohen protokolle të ndryshme, shabllone të kontratave, raporteve, vlerësimeve, etj.

**c) Angazhimi i stafit administrativ dhe profesional**

Për të rritur efikasitetin në qeverisje dhe menaxhim të Federatës, asaj do t'i shtohen profilet e caktuara si ai i trajnerit nacional për zhvillim, drejtorit teknik, zyrtarit të marketingut, kontabilistit, administratorëve, kryesuesit të referëve, etj.

**d) Përmirësimi i praktikave administrative dhe financiare**

Në aspektin administrativ do të përmirësohet administrimi i anëtarësisë dhe i kalendarit të garave e aktiviteteve të tjera. Po ashtu do të aplikohet kontabiliteti dhe auditimi cilësor financiar, si dhe ai i brendshëm posa administrata të konsolidohet më shumë.

**e) Rritja e cilësisë së komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm**

Rëndësi do t'i kushtohet komunikimit me të gjitha palët e përfshira në zhvillimin e tenisit. Do të krijohet një platformë e komunikimit me ITF e federatat e shteteve të rajonit, KOK, MKRS, etj. Po ashtu, do të krijohet një platformë e komunikimit të brendshëm me klubet, tenistët, trajnerat, referët, prindërit, etj. Komunikimi me publikun do të mirëmbahet më mirë përmes ueb faqes së Federatës dhe mediave sociale si Facebook. Krijimi i sistemit digjital të menaxhimit të informatave do të lehtësojë komunikimin dhe ndarjen e infromatave në kohë reale;

**2.2.2. OZh 2: Pjesëmarrje e shtuar e popullatës në sportin e tenisit**

Tenisi meriton të masovizohet në vendin tonë, që të krijohet një kulturë e përgjithshme popullore e të luajturit tenis. Federata i kushton rëndësi promovimit të tenisit dhe nxitjes së gjeneratave të reja që të merren aktivisht me tenis, sikurse nxitjes së qytetarëve që të merren me tenis në mënyrë rekreative – në veçanti personave mbi 35 vjet të cilët do t'i ekspozojnë ndaj tenisit edhe fëmijët e tyre.

**Masat për OZh 2:**

**a) Promovimi i tenisit te gjeneratat e reja**

Familjet e fëmijëve të vegjël duhet të tërhiqen që t'i angazhojnë fëmijët në tenis, ndërsa vet fëmijëve duhet t'u bëhet i dashur tenisi. Duke qenë se numri më i madh i fëmijëve të vegjël është nëpër shkolla, do të promovohet programi i tenisit në shkolla. Edhe mënyra të tjera të njohjes së fëmijëve me tenis do të aplikohen. Të tilla janë festivalet e tenisit në rrugë. Klubet nga ana e tyre do të bëjnë rekrutimin e grupmoshave te reja nëpër klube dhe do të kujdesen për përcjelljen e tyre nëpër grupmosha më të larta. Do të merren masa për edukimin e trajnerëve (meshkuj) për punë me vajzat, meqë praktikant tregojnë se vrazhdësia e trajnerëve shpesh është demotivuese për vajzat. Krahas kësaj, do të inkurajohet shumë dhe ndihmohen orvatjet për të shtuar konsiderueshëm numrin e trajnerëve femra.

**b) Rritja e cilësisë së organizimit të klubeve**

Rëndësi do t'i kushtohet ristrukturimit të veprimtarisë së klubeve. Federata do të synojë t'u ofrojë ndihmë klubeve për administrim, planifikim, raportim, sponsorizim, si dhe formalizim. Do të kategorizohen klubet dhe do të shpërblehen e ndihmohen klubet që e përqafojnë ndryshimin progresiv;

**c) Krijimi i kulturës së tenisit si rekreacion**

Tenisit është potencial shoqëror në këndvështrim të angazhimit të qytetarëve me aktivitete sportive deri më moshat më të shtyera. Për këtë duhet krijuar mundësi për qytetarët që tenisën ta praktikojnë si rekreacion. Do të bëhet një sistem i anëtarësimit të tenisistëve rekreativë dhe do të krijohen lehtësira për këta tenisistë në shfrytëzimin e terreneve të tenisit. Po ashtu do të organizohen turne rekreative dhe aktivitetet tjera të tenisit. Në pajtim me gjithëpërfshirjen si vlerë do të krijohen kushtet për personat me aftësi të kufizuara që të merren me tenis. Edhe pjesëmarrja e femrave do të nxitet posaçërisht.

**2.2.3. OZh 3: Përmirësimi i performancës në tenis përmes zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe atyre infrastrukturore**

Cilësia e tenisit varet shumë nga dy faktorë: nga zhvillimi i kapaciteteve njerëzore përmes programeve të zhvillimit profesional dhe ofrimit të mundësive për krijimin e përvojave ndërkombëtare dhe konkurrimit; si dhe përmes krijimit të kushteve në aspektin e infrastrukturës dhe pajisjeve.

**Masat për OZh 3:**

**a) Përmirësimi i infrastrukturës fizike për tenis**

Infrastruktura fizike e tenisit është tejet e varfër në Kosovë. Për këtë në vitet në vijim do të kërkohet që të ndërtohen terrene të reja të tenisit, sidomos në qytetet ku mungojnë ato, që secili klub të ketë mundësi për ushtrimin e këtij sporti. Projekti më i madh infrastrukturor është ndërtimi i Qendrës Nacionale të Tenisit në Prishtinë. Po ashtu duhet të përfundohet ndërtimi i kompleksit në Gjakovë. Do të bëhet mbulimi i disa terreneve ekzistuese (Prizren e Graçanicë) që të vazhdohet me aktivitete të tenisit edhe në kushte dimërore. Intervenimet e tjera në rregullimin e fushave dhe hapësirave përcjellëse përfshijnë instalimin e ndriçimit, rregullimin e sipërfaqëve të terreneve, ndërtimin e zhveshtorëve dhe lokaleve ndihmëse, etj.

**b) Hartimi dhe zbatimi i programeve për zhvillim**

Duke shfrytëzuar praktikën më të mira ndërkombëtare, dhe me ndihmën e ekspertizës së ITF, trajneri nacional do të hartojë programet për zhvillim. Këto programe përfshijnë programet e zhvillimit të tenisistëve sipas grupmoshave, me vizionin e përcjelljes së tyre prej një grupmoshe në tjetër; programin e zhvillimit profesional të trajnerëve dhe licencimin e tyre në disa nivele; zhvillimin profesional të referëve dhe licencimin e tyre me nivele të ndryshme të licencave; si dhe zhvillimin profesional të zyrtarëve të Federatës. Të gjitha këto fokus të veçantë do ta kenë përfshirjen e sa më shumë femrave.

**c) Përzgjedhja e kuadrit profesional**

Për të përmirësuar performancën në tenis, me rëndësi të madhe është aktivizimi i kuadrove profesionale. Prandaj, do të krijohet një sistem i përzgjedhjes së kuadrove më të mira dhe do të monitorohet e vlerësohet puna e tyre. Do të përzgjidhen selektorët për grupmoshat e ndryshme, si dhe do të krijohet një listë e referëve që do të angazhohen në gara.

**d) Pjesëmarrja në ngjarjet ndërkombëtare**

Pjesë e rëndësishme e zhvillimit është edhe pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare të tenisit, në mënyrë që në njërin anë të krijohen përvoja të reja dhe në anën tjetër të rritet konkurrueshmëria e tenisit tonë me atë ndërkombëtar. Do të vazhdojë të përkrahet pjesëmarrja e tenistëve në turne të TE dhe ITF, si dhe në turnetë e shteteve të tjera. Do të sigurohet pjesëmarrja e përfaqësuesve në kampionatet evropiane e botërore për të gjitha grupmoshat. Po aq me rëndësi do të jetë edhe pjesëmarrja në konferenca e trajnime të organizuara jashtë vendit, nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejt trajnerët, referët dhe zyrtarët e tenisit.

**e) Sigurimi i fondeve institucionale dhe mbështetjes së sponsorëve**

Shumë e rëndësishme është që krahas buxhetit të shtetit, i cili është tejet i kufizuar në krahasim me nevojat zhvillimore, të sigurohet një sistem i financimit të tenisit nga fondet alternative që përfshijnë agjensionet e institucionet e ndryshme dhe biznesin privat. Nga zyrtari i marketingut do të synohen fonde nga KOK/Solidariteti Olimpik, ITF, EU, etj. Do të lidhen marrëveshje me biznese për sponsorim të tenistëve dhe aktiviteteve të tenisit. Po ashtu do të bëhet një angazhim në ngritje të fondeve nga burime të tjera.

**f) Mbështetja financiare dhe institucionale për tenistët e talentuar**

Me qëllim që të ruhet potenciali i tenistëve më të shquar dhe të zhvillohet më tutje, Federata do të krijojë një sistem të qëndrueshëm të mbështetjes financiare dhe institucionale për tenistët e talentuar. Kjo do të mundësohet duke hartuar rregulloret dhe procedurat për subvencionim, bursa, shpërblime, mirënjohje, etj.

### 3. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit parasheh objektivat zhvillimore të detajuara dhe të konkretizuara, hapat që do të ndërmerren, si dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Objektivat e paraqitura janë të ndryshuara dhe të arritshme. Në këtë plan ato paraqiten për periudhën 2019-2021, meqë ky plan tashmë njëherësh është edhe avancim, edhe rishikim dhe rivlerësim i arritjeve të planit 5-vjeçar 2017-2021.

Plani i detajuar i veprimit është bashkangjitur tek Shtojca 1, në fund të këtij dokumenti.

Krahas kësaj, tek Shtojca 2 është paraqitur ecuria e deritashme e objektivave të kuantifikuara për secilin element të planit origjinal, si dhe janë shtuar objektiva të tjera.

### 4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

